



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 95/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha  | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 19.02.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin e ofertave teknike të operatorit ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt, “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrrrotullimi Shqiponja Loti 1*”, me nr. REF-86046-09-17-2018, me fond limit 15,376,365.01 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza II në datën 19.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k.  
*Adresa: Rr. “Islam Alla”, P. IVEA, 3/5, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
*Adresa: Rr. “Sami Frasheri”, Nr.33, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### ***Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### ***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 18.09.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt, “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrrrotullimi Shqiponja Loti I*”, me nr. REF-86046-09-17-2018, me fond limit 15,376,365.01 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza II në datën 19.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar

II.2 Në datën 28.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 08.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.4. Në datën 03.12.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë të kualifikuar, për paraqitjen e propozimeve teknike dhe ekonomike në datë 19.12.2018, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 19.12.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në të cilën kanë paraqitur propozim vetëm operatori ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k,

II.6.Në datën 27.12.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik të vetëm, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për propozimin teknik, ku rezultoi: “A&E Engineering” sh.p.k 67.666 pikë.

II.7.Në datën 28.12.2018 operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me vlerësimin e propozimit të tij teknik, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Se pari , persa i perket Vleresimt nga Autoriteti juaj ne lidhje me tekniken e prpozuar ju bejme me dije se ne si studio kemi shprehur interes dhe kemi marre pjese ne 11 procedura te tenderuara gjate periudhes shtator dhjetor 2018 dhe ne te gjitha keto procedura jemi kualifikuar ne fazen e pare dhe ne fazen e 2 e perfomances teknike dhe ofertes finaciare jemi vleresuar gjithmone mbi 71 pike . Dhe ne keto procedura jemi prezantuar me te njejtin staf . Konkretisht ne proceduren e mbikqyrjes loti 2 po e njeta kvo na ka vleresuar me 72 pike... dhe ne te gjitha procedurat e pjesmarrese ne si operator jemi vleresuar nga e njeta kvo sepse vetem keta anetare kvo ka vendosur Arrsh per procedurat e mbikqyrjes jemi vleresuar gjithmone mbi 70 pike.*

*Se dyti, persa i perket kualifikimit KVO (Komisioni vleresimit te Ofertave)pasi shoqeria “A&E Engineering” sh.p.k i ka plotesuar me se miri kriteret e kerkuara nga DST(Dokumentat Standarte te tenderit) me objekt “Supervizion punimesh rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta, rrethrotullimi Shqiponja Loti 1”. Specifikojme keshtu qe stafi i propozuar ne kete procedure eshte i specializuar dhe ka qene, mbikqyres ne mjaft tendera te tjere te realizuar me sukses. Inxhinieret jane te licensuar per mbikqyres ne mjaft tendera te tjere te ralizuar me sukses. Inxhinieret jane te licensuar per mbikqyrje dhe me pervojen e duhur. Persa perket i perket puneve, te ngjashme ne kemi reaktivuar me sukses disa kontrata me autoritetin dhe jo vetem shpresojme qe ankesa jone te merret ne konsiderat nga ana e Autoritetit tuaj dhe ti jepet rendesia e duhur pasi kohet fundit Shoqeria “A&Engineering” po ndjehet teje e diskriminuar qofte ne lidhje me vleresimet teknike ashtu dhe me shqyrtimin me korrektesi profesionalizem dhe menyre te drejt te ankesave qe kemi paraqitur. Duke ber te mundur kualifikimin e operatorit ekonomik “A&Engineering” sh.p.k , stafi yne do te kontribojte per realizimin me sukses te detyres dhe ne perputhje me kerkesat e Autoritetit tuaj kontraktues. Ne te kundert, ne do te ndjekim rrugen qe parashikon ligji per te gjetur te drejten qe mendojme se na eshte mohuar.[...]”*

II.8. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 11917/2 Prot. datë 04.01.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “A&E Engineering” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën, me argumentimin si më poshtë vijon:

*“[...]Për metodologjinë e propozuar jeni vlerësuar nga KVO mesatarisht me 20.66 pikë me arsyetimin që në materialin e paraqitur nga Ju nuk është dhënë shpjegim bindës mbi Metodologjinë e mbikqyrjes së Punimeve në këtë objekt. Sipas arsyetimit të KVO, materiali i paraqitur nga Ju në përgjithësi është bazuar në statistika të përgjithshme (informacioni paraqet një situatë të përgjithshme gjeologjike e hidrologjike që në përgjithësi trajton më shumë zonën ndërmjet qytetit të Krujës dhe të Tiranës se sa zonën ku do të ndërtohet objekti). Po sipas këtij arsyetimi, nuk keni përshkruar mënyrën e përqasjes teknike se si do të adaptoni zgjidhjet që propozoni për kryerjen e punimeve që do të kryhen në këtë objekt. Vlerësohen mangësi në parashikimin për kohën dhe mënyrën e ndjekjes së kontrollit të pikeve të punimeve në objekt nga ana e topografit, staf i operatorit etj. Për vlerësimin për kualifikimet e stafit të propozuar jeni vlerësuar nga KVO*

mesatarisht me 40 pikë me arsyetimin që në stafin e paraqitur për këtë procedurë prokurimi keni paraqitur një listë të stafit mbikqyrës ku në përbërje të tij ka edhe personel jo të licensuar për punime të mbikqyrjes gjë e cila ndikon në mungesën e përvojës në vite të stafit dhe performancën e punës vlerësuese që kërkohet të japë stafi mbikqyrës në objekt. Në certifikatat e paraqitura për kualifikimet e stafit dokumentohen vetëm dy certifikata mjedisi dhe një certifikatë për “Eficiencën e energjisë në Ndërtesa”!! Po sipas këtij arsyetimi (KVO) eksperiencë Juaj e stafit, që do marrin pjesë në procesin e punës, është kryesisht eksperiencë në fushën e ndërtimit godina civile, ujesjelles kanalizime në infrastrukture rrugore por që nuk janë të llojit të objektit që kërkohet në Termat e References, pjesë integrale të DST -ve. Për vlerësimin për përvojën në punë të ngjashme jeni vlerësuar nga KVO mesatarisht me 7 pikë me arsyetimin që në materialin e paraqitur listohen punë të ngjashme që janë kryesisht mbikqyrje e punimeve të ndërtimit, shkolla, ujesjellesa, elektrike dhe ato të infrastrukturës rrugore por jo në mbikqyrje rrugë të kategorisë që është prokuruar në rastin konkret, kjo lidhur specifikisht me natyrën e shërbimit që kërkohet në objektin që prokurohet.

Si Konkluzion: Në vlerësimin tonë, si KSHA, gjykojmë që vlerësimi i bërë nga KVO, përshkruar kjo në proces-verbalin nr 5 të datës 27.12.2018, si dhe në arsyetimet e antarëve të KVO-së për dy pikat e ankesës Tuaj në lidhje me përvojat për punë të ngjashme dhe në kualifikimet e stafit të propozuar për kryerjen e punës, Ju, si ofertues jeni vlerësuar me pikë pozitive brenda limitit të vlerësimit përcaktuar në ligj pa ju skualifikuar për këto pika. Për vlerësimin e bërë nga KVO për metodologjinë e paraqitur në propozimin Tuaj, vlerësojmë se ky vlerësim i cili përbën një vlerësim subjektiv i cili është i lidhur me përvojën, eksperiencën, dhe kualifikimet e antarëve të KVO por gjithsesi sipas mendimit tonë është pozitiv për faktin se jeni Vlerësuar mbi 20 pikë, pra mbi limitin e ulët të pikëve që përcakton ligji edhe pse në total Vlerësimi i bërë nga KVO paraqitet nën 70 pike.[...]”

II.9.Në datën 11.01.2019 operatori ekonomik ankimues ”A&E Engineering” sh.p.k. ka paraqitur, ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, me argumentin si më poshtë vijon:

“[...]Se pari: Metodologjia e mbikqyrjes së Punimeve në këtë objekt është hartuar në përmbushje të kërkesave Dst dhe Termave të References dhe vlerësimi në pikë duhet të bëhet mbi bazën e ketyre kërkesave duke mos lene hapësira për subjektivizem në vlerësim.

Se dyti: Në lidhje me vlerësimin për kualifikimet e stafit të propozuar në Dokumentat Standarte të Tenderit pika 2.3.3 kërkohet një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve të saj, lista e personelit të përfshihen CV-të e tyre, diplomën, kontratën e punës, si dhe licencat profesionale për mbikqyrje.

Sqarojmë se: dokumentacioni i kërkuar shoqëruar me listën e stafit të propozuar është paraqitur në fazën e parë dhe të dytë të kësaj procedure. Në datën 17.09.2018 në faqen e App është publikuar nepermjet sistemit elektronik vlerësimi për fazën e parë, ku oferta jone si ofertor është pranuar. Në tabelën e stafit të propozuar kemi paraqitur stafin kryesor dhe mbështetës, stafi kryesor mbikqyrës është i pajisur krejtësisht me licence mbikqyrje dhe ushtojnë prej shumë vitesh detyrën e drejtuesave teknike të mbikqyrjes dhe projektimit pranë kompanisë tone. Stafi mbështetës i propozuar ka vite eksperiencë dhe ushtron detyrën e drejtuesit teknik në projektin, ky staf është paraqitur përtej kërkesave të Dst dhe nuk duhet të përbej shkas për vlerësim të ulët pasi kriteret përmbushen totalisht nga stafi kryesor. Sipas vlerësimit të Kvo eksperiencë e staffit tone është përgjithsisht në fushën e ndërtimit godina civile, ujesjelles-kanalizimeve në infrastrukturen rrugore por që nuk janë të llojit të objektit që kërkohet në termat e references, pjesë integrale të Dst-ve. Sqarojmë se: Specifikat e vecanta të punimeve të ndërtimit në mbikqyrje janë të përcaktuara me ligj dhe

kategorite e pasqyruara ne licencat profesionale te shoqerise dhe stafit jane tregues i fushshes se veprimtarise se ushtruar. Kategoria e punimeve te kerkuara ne piken 2.3.2 te Dst permbushtet totalisht nga stafi kryesor i paraqitur. -Ne lidhje me pervojen ne punes se ngjashme jemi vleresuar nga Kvo mesatrisht me 7 pike me arsyetimin qe ne materialin e paraqitur listohen pune te ngjashme qe nuk jane te kategorise dhe natyres se sherbimit te objektit te prokuruar. Sqarojme se: Ne Dokumentat Standarte te Tenderit, Kapaciteti Teknik, Pika 2.3.1 Përvoja e mëparshme, kerkohet : Kandidati/ofertuesi duhet te ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 40% te fondit limit te kontrates qe prokurohet, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. Sherbimet e ngjashme te paraqitura ne fazen e pare dhe te dyte jane kontrata te permbushura me sukses me Autoritetin Kontraktor gjate tre viteve te fundit. Theksojme se shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës perputhen me natyren e objektit të prokurimit. Nder vite kemi patur edhe shume kontrata te tjera bashkpunimi te suksesshme me Autoritetin Rrugor Shqiptar. [...]”

II.10.Në datën 22.01.2019 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.523/1prot., datë 21.01.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues ”A&E Engineering” sh.p.k. mbi vlerësimin e propozimit teknik të këtij të fundit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë KPP, rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vlerësimit të ofertave, mbi vlerësimin dhe argumentimin e propozimeve teknike, të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues ”A&E Engineering” sh.p.k., pasqyrohen pikët si më poshtë vijon:

| Anëtari i KVO-së | Përvoja në punë të ngjashme 0-10 | Metodologjia e propozuar 20-30 | Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50 | Transferimi i njohurive (nuk kërkohej) 0 | Total |
|------------------|----------------------------------|--------------------------------|--------------------------------------------------|------------------------------------------|-------|
| 1                | 9                                | 20                             | 30+10                                            |                                          | 69    |
| 2                | 7                                | 21                             | 30+10                                            |                                          | 68    |
| 3                | 5                                | 21                             | 30+10                                            |                                          | 66    |

III.1.2. Në nenin 3, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Kontratat e konsulencës” janë kontratat për shërbime publike konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë”.

III.1.3. Në nenin 37 “Shërbimet e konsulencës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 34/1 të LPP-së, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.*

*ii. Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:*

*-përvojën e konsulentit;*

*-cilësinë e metodologjisë së propozuar;*

*-kualifikimet e stafit kryesor të propozuar;*

*-transferimin e njohurive, nëse kërkohet. “Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t’i shtohen kriterit “kualifikimet e stafit kryesor të propozuar” Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 e, më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Minimumi i pikëve të propozimit teknik për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik është 70 pikë. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të Tenderit Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij”.*

III.1.4. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 5, pika 5.1. “Vlerësimi i Propozimeve teknike”, përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dokumentat e Tenderit dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson Termat e References, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në Dokumentat e Tenderit, do të refuzohet. Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në Dokumentat e Tenderit. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në Dokumentat e Tenderit. Nëse Dokumentat e Tenderit parashikojnë një rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet”.*

III.1.5. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 5, pika 5.5. “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

*Kriteret e vlerësimit*

*Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:*

*Kriteret e Vlerësimit*

*Pikët*

*(i)Përvoja per Pune te Ngjashme te Konsulentit*

*[0-10]*

*Nënkriteret*

*i/a Përvoja për punë të ngjashme*

*40-80%*

*Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.*

*i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%*

*Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.*

*Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.*

*(ii) Metodologjia e Propozuar*

*[20-30]*

*Nënkriteret*

*ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia*

*[20-30%]*

*ii.b Plani i punës dhe grafiku u dorëzimit të projektit*

*[30-40%]*

## ii.c. Organizimi i Stafit

[20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafit: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

### (iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

#### a- Kualifikim i përgjithshëm

[5-20%]

#### b. Eksperienca në fushën përkatëse

[30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencë.

- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

### (iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet)

[0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Total(Propozimi Teknik)

100%

□ Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.”

III.1.6. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatorëve ekonomikë i është kërkuar përmbushja e kushteve si më poshtë:

#### “2.3.1 Përvoja e mëparshme:

Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit të kontratës që prokurohet, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

*\*Kjo të vërtetohet me kopje të kontratave / vërtetim të lëshuar nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimi i realizuar. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohet, fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara .*

*\*Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.*

*2.3.2 Licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve objekt i kontratës, (për mbikqyrje), të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë si më poshtë:*

- NP – 1 Punime germimi në toke.
- NP – 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP – 5 Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- NP – 9 Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.
- NP – 11 Ndertime për N/Stacione, kabina e transformatoreve linja e TN e të mesem dhe shpërndarja e energjisë..
- NS – 1 Punime për prishjen e ndertimeve
- NS – 6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS – 7 Bariera dhe mbrojtje rrugore
- NS – 8 Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- NS – 10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- NS – 13 Impiante dhe Linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- NS -18 Punime topogjeodezike.
- NS – 20 Shpime gjeologo - inxhinierike, puse e shpime për ujë.

*\*Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.*

*(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit shtetëror kompetent Shqiptar, konform VKM 759, datë 12.11.2014, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016)*

*2.3.3 Një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve të saj, lista e personelit të përfshihen CV-të e tyre , diplomën , kontratën e punës, si dhe licencat profesionale për mbikqyrje,.*

*Lista e stafit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, të përmbajë:*

- Drejtuesin e projektit që duhet të jetë inxhinier ndërtimi, me eksperiencë pune në mbikqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimit të volumeve,
- Mbikqyrësin e materialeve që duhet të jetë inxhinier ndërtimi, me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.
- Mbikqyrësin për punimet topografike që duhet të jetë inxhinier topograf, me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e objektit.
- Mbikqyrësin (gjeolog), duhet të jetë inxhinier gjeolog me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet gjatë gërmimit.



- Mbikqyrësin për punimet e sinjalistikës duhet të jetë inxhinier me licence për punimet e sinjalistikës rrugore dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.
- Mbikqyrësin për punimet e rrjetit të ujesjellesit që duhet të jetë inxhinier hidroteknik, me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.
- Mbikqyrësin për punimet e gjelberimit që duhet të jetë inxhinier mjedisi ose arkitekt, me licence dhe eksperiencë pune në këtë fushë.
- Mbikqyrësin për punimet elektrike duhet të jetë inxhinier elektrik, me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.
- Mbikqyrësin për veprat e artit që duhet të jetë inxhinier konstruktor me eksperiencë pune në projektim dhe në zbatim me licensë për këtë qëllim.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në staf një specialist / Ekspert Gjeomjedis ( me kontratë pune të perkohshme) për ekspertizë Gjeoambjenti, dhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për të cilin duhet të paraqesë ,Diplome, CV, Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- \*Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

#### 2.3.4 Kandidati/ofertuesi të paraqesë certifikatat të vlefshme/të perditesuara.

ISO 9001 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë)

ISO 14001 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit)

ISO 18001 (Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Punë)”

III.1.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, ku parashikohet se, në tërësi propozimi teknik i nënshtrohet vlerësimit të tre elementëve kryesorë, të tillë si përvoja e konsulentit, kualifikimi i stafit të propozuar si dhe metodologjia e propozuar nga operatorët ekonomikë, të kualifikuar në fazën e parë të procedurës, si dhe duke pasur parasysh të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë të propozimit teknik të dorëzuar në këtë procedurë prokurimi, konstaton se, në lidhje me eksperiencat e mëparshme operatori ekonomik ankimes ankimues ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë shërbimi datë 24.06.2009, lidhur ndërmjet shoqërisë “A&E Engineering” sh.p.k dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, me objekt “Mbikqyrje punimesh “Sistemi i Asfaltimit rruga Tre Urat - Leskovik”, me vlerë kontrate 7,120,718 lekë me tvsh, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Kontratë shërbimi datë 28.09.2009, lidhur ndërmjet shoqërisë “A&E Engineering” sh.p.k dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, me objekt “Mbikqyrje punimesh “Ndërtim Rrugë Kanali i Cukës – Butrint, loti 2”, me vlerë kontrate 5,303,262.82 lekë me tvsh, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

III.1.8. Gjithashtu, rezulton se, është paraqitur CV, mbi eksperiencat e realizuara nga kompania “A&E Engineering” sh.p.k., ku janë renditur një sërë shërbimesh konsulence të kryera nga kjo kompani në vite, si edhe një përshkrim i përgjithshëm në lidhje me aktivitetet e shoqërisë.

III.1.9. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar objektit të prokurimit, operatori ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k. në veprimtarinë e tij, shfaq eksperiencë në fushën e mbikqyrjes së punimeve, ku përfshihen mbikqyrje punimesh për ndërtime në

infrastrukturën rrugore, ndërtime në infrastrukturën e ujësjellësave, ndërtime civile etj., duke vërtetuar se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, por në asnjë rast nuk vërteton kryerjen e shërbimeve të ngjashme në punime specifike me objektin e prokurimit i cili në volumn më të madh të tij ka objekt ndërtimin e nje mbikalimi. Në këto kushte, pretendimi i këtij operatori ekonomik për një vlerësim maksimal të përcaktuar për këtë kriter, nuk është i bazuar. Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Komisioni i vlerësimit të ofertave, ka vlerësuar mesatarisht operatorin ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke mos vlerësuar as me minimumin e pikëve dhe as me maksimumin e tyre. KPP gjykon se, vlerësimi është i matshëm në kushte kur niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar kontratat e ngjashme në tërësinë e tyre, duke përfshirë shumë elementë të tillë si data e lidhjes, mënyra e realizimit, objekti i kontratës, vlera e saj etj, dhe rrjedhimisht vlerësimi maksimal nuk mund të jepet, duke parë dhe analizuar vetëm numrin e kontratave të paraqitura, pa realizuar brendinë e tyre me të gjithë elementët e përmendur më sipër. Përsa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues lidhur me eksperimentat e ngjashme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë një vlerësim të arsyeshëm.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.1.10. Në lidhje me metodologjinë e propozuar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar metodologjinë përkatëse, në të cilën jepet një përshkrim i përgjithshëm të zonës, metodologjinë, zgjidhjen e projektit, planin e punës dhe grafikun e detajuar të realizimit të shërbimit. Nga shqyrtimi i metodologjisë të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni konstaton se, lidhur me përjasje teknike de metodologjinë, ankimuesi nuk ka përshkruar një përjasje teknike konkrete për kryerjen e shërbimit të mbikqyrjes, si dhe nuk ka përshkruar planin e masave për organizimin e punës të detajuar, por e ka bërë përshkrime të përgjithshme lidhur me to. Gjithësesi, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime minimale, në kushtet kur, operatori ekonomik provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion ku nuk meriton për t'u vlerësuar me pikët minimale.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.1.11. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi vlerësimin me pikë për stafin kryesor të propozuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara duke u shoqëruar me licencat profesionale në projektim, CV-të, kontratat e punës, diplomat, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre. Nga shqyrtimi i tyre konstatohet se, në eksperiencat e stafit përfshihen mbikqyrje punimesh për ndërtime në infrastrukturën rrugore, ndërtime në infrastrukturën e ujësjellësave, ndërtime civile etj., duke vërtetuar se kanë kryer eksperiencat të ngjashme me objektin e prokurimit, por në asnjë rast nuk vërtetojnë se kanë eksperiencë specifike për kryerjen e shërbimeve të mbikqyrjes në punime specifike si objekti i prokurimit i cili në volumn më të madh të tij ka objekt ndërtimin e një mbikalimi. Në këto kushte, pretendimi i këtij operatori ekonomik për një vlerësim maksimal të përcaktuar për këtë kriter, nuk është i bazuar. Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Komisioni i vlerësimit të ofertave, ka vlerësuar mesatarisht operatorin ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke mos vlerësuar as me minimumin e pikëve dhe as me maksimumin e tyre. KPP gjykon se, vlerësimi është i matshëm në kushte kur niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar kualifikimet e përgjithshme dhe eksperiencat e stafit në shërbime specifike. Përsa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues lidhur me eksperiencat e stafit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë një vlerësim të arsyeshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulencë*”, me objekt, “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrrrotullimi Shqiponja Loti 1*”, me nr. REF-86046-09-17-2018, me fond limit 15,376,365.01 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza II në datën 19.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 45 protokolli Datë 11.01.2019**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**